



Më
Dana

31- 05- 18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin Ibrahim Idrizi dhe zyrtare ligjore Albana Ajvazi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale “Lidhja e pa autorizuar në shërbime” nga neni 321 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II. nr. 56-1/2017, e datës 27.01.2017, pas mbajtjes së seancë filletar publike me datë 23.03.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Ismet Rahmani dhe të akuzuarit [REDACTED], të njëjtën datë mori dhe komunikoi, kurse me datën 29 mars 2018 e përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDACTED] i lindur më dt. [REDACTED] në [REDACTED] Komuna Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] me numër personal [REDACTED], me vendbanim në fshatin [REDACTED] – Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në firmën [REDACTED] me pagë mujore 250€, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt. 13.10.2016, në fshatin [REDACTED] Komuna Ferizaj , i pandehuri në shtëpinë e tij në mënyrë të kundërligjshme ka shfrytëzuar energjinë elektrike pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar – KEDS-it, në atë mënyrë që ishte kyçur direkt në rrjetin elektrik, jashtë pikës matëse – njehsorit elektrik, ku ka furnizuar pajisjet elektrike shtëpiake me energji elektrike, me qëllim të mos regjistrimit të energjisë elektrike të shpenzuar, me ç'rast KEDS-it, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 234.49€.

- me të cilën ka kryer veprën penale “Lidhja e pa autorizuar në shërbime” nga neni 321 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 41, 49, 50, 51, 52, 73, 74 dhe 321 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPP-ës, e

G J Y K O N

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/TRE/MUAJ dhe dënim gjobe në lartësi prej 300/treqind/ €, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në periudhën kohore prej 1/NJË/VITI pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale të natyrës së njëjtë (koha e verifikimit).

Obligohet i akuzuari që të kompensoj të dëmtuarës KEDS-i në shumë prej 234.49 €.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20/njëzetë/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me aktakuzën e evidentuar PP/II. Nr. 56-1/2017 dt. 27.01.2017, ka akuzuar [REDACTED], për shkak të veprës penale “Lidhja e paautorizuar në shërbime” nga nen 321 të KPRK-së.

Gjkata duke vepruar sipas kësaj aktakuze mbajti shqyrtimin fillestar me datë 23.03.2018, në të cilën shqyrtim i akuzuari u deklarua fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza.

Prokurori i shtetit Ismet Rahmani, me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin.

Gjkata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga nen 248 par. 1 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë: procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike në terren me numër 1335136 datë 13.10.2016, fatura DFE16HP12767, e dt. 17.10.2016, foto dokumentacioni i njehsorit elektrik – vendi i ngjarjes si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore apo faktike.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjkata, konform nenit 248 par. 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk

është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsyе ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale “Lidhja e paautorizuar në shërbime” nga nen 321 të KPRK-së meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësishët në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik, ku ka furnizuar pajisjet elektrike shtëpiake me energji elektrike, me qëllim të mos regjistrimit të energjisë elektrike të shpenzuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrëthanat në kuptim të nenit 64 të KPK-ës dhe gjeti si rrëthanë lehtësuese se i akuzuarit ka pranuar fajësinë në të gjitha fazat e procedurës penale, deri më tanë rezulton se nuk është dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, si dhe rrëthanën se është prind i një fëmijëve dhe ka gjendjen e dobët ekonomike, kurse në rastin konkret nuk gjeti rrëthanë rënduese posqë vlerësoi peshën konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e caktuar pa ekzekutimin e tij, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuarit ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënameve i paraparë në nenin 41 të KPK-ës përkatësisht dënim i shqiptuara është plotësish i justifikueshëm dhe në përshtatje me rrëthanat e kryerjes, rrëzikshmërinë e saj dhe të autorit e që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përbaj personat e tjera nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Në kuptim të nenit 463 par.2 të KPP-së, obligoi të akuzuarin që në emër të kërkesës pasurore juridike të i kompensoj të dëmtuarës KEDS shumën prej 234.49€, me që të dhënat e mbledhura në procedurë penale paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë të kërkesës pasurore juridike (fatura për shfrytëzimin e energjisë elektrike).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPP-ës, obligohet i akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20/njëzet/€, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P. nr. 233/17, më 29.03.2018.

Zyrtare ligjore,

Albana Ajvazi

Gjyqtari,

Ibrahim Idrizi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 dite, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.